

V E N D I M
Nr.523, datë 21.8.1998

**PËR REGJISTRIMIN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE QENDRORE
DHE LOKALE DHE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

Në mbështetje të ligjit nr.8095, datë 21.3. 1996 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë dhe në zbatim të programit të qeverisë për reformën në administratën publike qendrore dhe lokale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Regjistrimin e punonjësve të të gjitha niveleve në administratën publike, qendrore dhe lokale, duke filluar nga data 1 shtator 1998.

2. Regjistrimi i punonjësve të bëhet sipas një formulari të titulluar "formulari i të dhënave të personelit", që më poshtë do të përmendet si "Formulari", sipas modelit të bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Marrja e këtyre të dhënave të shërbejë për krijimin e sistemit të kompjuterizuar të informacionit për personelin e administratës publike, qendrore dhe lokale.

4. Formulari të plotësohet personalisht nga çdo punonjës, i cili mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave, që kërkohen në formular.

5. Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave të marrë masat e duhura për përcaktimin e nevojave dhe shpërndarjen e formularëve.

6. Personi përgjegjës për personelin ngarkohet me shpërndarjen, mbledhjen, si dhe dërgimin brenda afatit të caktuar të formularëve të plotësuar pranë Departamentit të Administratës Publike.

Përpara dërgimit të tyre, personi përgjegjës për personelin kontrollon nëse formularët janë plotësuar saktësisht për çdo të dhënë të kërkuar, si dhe vërtetësinë e të dhënave të shënuara, në përputhje me dosjen përkatëse të personelit.

7. Punonjësi, që punësohet për herë të parë në administratën publike, plotëson formularin dhe përgjegjësi për personelin detyrohet, që brenda 15 ditëve t'ia dërgojë atë Departamentit të Administratës Publike.

Për çdo ndryshim që mund të ndodhë në të dhënat që janë kërkuar nga punonjësi, pas plotësimit të formularit si p.sh.: kualifikime, ndryshimi i vendit të punës, ndryshime të gjendjes familjare etj., përgjegjësi për personelin detyrohet që brenda 15 ditëve të njoftojë Departamentin e Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave.

8. Personat përgjegjës për personelin, si dhe personat që punojnë për krijimin e sistemit të kompjuterizuar të informacionit për personelin e administratës publike qendrore dhe lokale, mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e fshehtësisë së informacionit.

Personave përgjegjës për personelin dhe atyre që merren me administrimin dhe përpunimin e të dhënave, ju ndalohet përhapja dhe publikimi në çdo formë i të dhënave personale të marra nga punonjësit, nëpërmjet formularit të plotësuar.

9. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave të përcaktojë afatet e shpërndarjes së formularëve, të plotësimit dhe të dërgimit të tyre pranë këtij departamenti.

Personat përgjegjës për personelin ose në mungesë të tyre, personat që do të ngarkohen me këtë detyrë, të marrin të gjitha masat e nevojshme për respektimin e këtij vendimi.

10. Për mosplotësimin e detyrimeve dhe kërkesave të parashikuara në pikat 4, 6, 7, 8 e 9 të këtij vendimi ndaj personave përgjegjës merren masa disiplinore sipas nenit 32 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, kurse ndaj nëpunësve të thjeshtë në kuptim të pikës 3 të nenit 2 të këtij ligji, masat disiplinore jepen sipas Kodit të Punës.

11. Ngarkohet grupi i punës “Për reformën në administratën publike”, ngritur me urdhër nr.3387, datë 22.7.1998 të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, të monitorojë dhe të raportojë pranë Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Koordinimit Qeveritar për ecurinë e zbatimit të këtij procesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano